

*Blendiana Nuredini*

# *Rrugët e jetës*

*Blendiana Nuredini*



**Është nxënëse e klasës së gjashtë**

**në Shkollën fillore periferike komunale "Fan Noli" të f. Pallaticë.**

**Lindi në Tetovë në vitin 2008, bashkjeton me familjen në f. Pallaticë.**

**Është vepra e parë e saj.**

**Me krijime letrare poetike fillon në klasë të gjashtë,**

**gjegjesisht me postimin e poezisë së parë "Vendlindjes" në shtator, te faqja e shkollës.**

**Më pas u rradhitën edhe poezitë tjera të cilat ishin parakusht për dalje në dritë të veprës.**

**Blendiana është nxënëse e shkëlqyeshme, merr pjesë në shumë aktivitete shkollore.**

**Është ardhëria e krijimeve letrare në f. Pallaticë dhe më gjërë.**

*Tetovë  
2020*

*Blendiana Nuredini*

*Rrugët e jetës*



*Tetovë  
2020*

*Blendiana Nuredini*

*Rrugët e jetës*

*Tetovë*

*2020*

*Recensent: Muaxher Haruni*

*Lektor: Blerim Muredini*

*Kopertina dhe dizajni: Stefan Grunevski*

*Rradhitjen kompjuterike: Stefan Grunevski*

*Rradhitjen teknike: Stefan Grunevski*

*Shtypshkronja: Tringa Design*

*Tirazhi: 300*

Këtë vepër ua dedikoj atyre që më përkrahen në çdo hap të këtij rrugëtimi dhe që gjithmonë janë ndjerë krenarë me punën time. Familjes sime...



## **Gjyshit tim**

Shtatë shkurti, ditë e shtunë  
E mora lajmine trishtuar,  
Se ti, ke ikur nga kjo botë,  
Këtë dhembje se duroj dotë.

Me veprat tua, ende jeton,  
Kush ka dhimbje, ende të kërkon,  
Për çdo fëmijë, plak e të rri,  
E vetmja shpresë në sëmundje, ishe ti,  
Në çdo dhimbje e shqetësim,  
Ishe shpresë e lehtësim.

E di Gjysh, se më shiqoni,  
Promovimin e librit ma uroni,  
Unë jam mbesa juaj e parë,  
Andaj dua t'iu bëj krenar,  
Juve veprën ua dedikoj,  
Kurrë për jetë nuk iu haroj.

## **Atdheu**

Kudo që të shkoj

Kudo që të jem,

Tek atdheu im

Mendejn do ta kem.

Atdheu është i shtrenjtë,

Dhe kur nuk harohet,

Është vend i përkryer

Ku të gjithëve, ju jetohet.

Ai është i çmushëm

Unë e admiroj,

Jamë shumë e lumtur

Që në atdheun tim, jetoj.



## **Babi**

Babi im shumë të dua  
Emri më i shtrenjtë  
Në jetë, je për mua,  
Gjithmonë unë të ëndëroj  
Nga zemra ime nuk të largoj.

Gjithmonë dëshirat mi plotësoi  
Asnjëherë nuk më qortoi,  
Gjithmonë më ledhatoi,  
Babi im, është ai që më edukoi.

Nuk kam fjalë të përshkruaj  
Një Baba të tillë,  
Thjesht dua të të them,  
Je Babai më i mirë.

## **Biblioteka**

Në bibliotekë  
Ka shumë qetësi,  
Sepse në bibliotekë  
Njerëzit marrin dituri.

Lexojmë libra,  
Gjëra me vlerë mësojnë  
Ardhmërinë e tonë,  
Ta ndriçojnë.

Në bibliotekë  
Lexojmë e mësojmë,  
Dituri fitojmë,  
Shoqërisë ti ndihmojmë.

## **Dëshirat**

Festat po afrohen,  
Dëshirat e fëmijëve,  
Po plotësohen.

Të gjithë dëshirojnë,  
Bredhin në shtëpi,  
Vitin e Ri ta festojmë,  
Me lumturi e harmoni.

Babadimri letrat i pranon,  
Fëmijeve, dëshirat ua plotëson,  
Dhuratat po shtohen,  
Fëmijët po gëzohen.

## **Dimri**

Erdhi dimri me stuhi,  
Natyra u mbush me bardhësi,  
Fëmijët rrëshqasin me sajë e ski.

Nëpër fusha, nëpër male,  
Bie bora me stuhi,  
Nga të shikosh,  
Vendi është i mbushur,  
Me bardhësi.

Në fushë e në male,  
Frynë veriu,  
Nuk është jashtë  
Më bariu.  
Dimri mik me borën,  
Pa doreza ma ngrinë dorën.

## **Ditëlindja**

Ditëlindjen time mezi e pres,  
Se është ditë e madhe, kjo festë,  
Shokë e shoqe dua t'i mirëpres,  
Se është e imja, kjo festë.

Dua të festoj, ditëlindjen time  
Me shoqet e fëmijërisë sime,  
Ti kujtoj ato me mall,  
Se shumë kohë, ato s'i kam parë.

## **Dua një botë**

Dua një botë të lumtur pa lotë,  
Dua një botë me gëzim plotë,  
Dua një botë më të bukur se sa kjo sot,  
Dua një botë pa armiqësi,  
Dua një botë me miqësi,  
Dua një botë pa robëri,  
Dua një botë luftë të mos ketë,  
Dua një botë që nuk ka hidhërimë,  
Dua një botë që nuk ka mundime,  
Dua një botë me njerës të barabartë,  
Dua një botë pa krye lartë,  
Dua një botë pa varfëri,  
Dua një botë me harmoni,  
Kjo është bota që unë e dua,  
Është bota më e mirë, për mua.

## **Dua të kursej**

Dua të kursej  
Para të grumbulloj,  
Dhe fëmijëve të varfër  
T'iu ndihmoj.  
T'iu dhuroj ushqim  
Të ushqehen,  
T'iu dhuroj shpresë,  
Të punojnë e të fitojnë  
Që një ardhmëri ,  
Më të mirë të ndërtojnë.  
Dua të kursej  
T'iu ndihmoj jetimëve,  
Që qëndrojnë rrugëve,  
Netëve dimrore.  
Nuk kanë ku të strehohen,  
Ku të marrin dashuri,  
Sepse nuk i kanë,  
Prindërit e tyre.  
Dua të kërsej,  
Para të fitoj,  
Dhe fëmijëve të botës  
T'iu ndihmoj.

## Edhe unë dua...

**B**otën dua ta shijoj

**L**ibra shumë unë të lexoj

**E**rësira të mos egzistoj

**N**dershmëri unë meritoj

**D**ituri të fitoj

**I**mzagjimatën ta forcoj

**A**rdhmëri të mirë unë synoj

**N**ë jetë e lumtur unë jetoj

**A**tdheun tim kurrë se haroj.



## **Ëndërrat e Jeartit**

Jearti shumë ëndërronte  
Në hënë, Ai të shkonte,  
Me anije kozmike të udhëtonte.

Jearti në ëndër pa,  
Se në qiell shkoi  
E hënë e vizitoi.

Jearti anijen kozmike  
Kur e zbuloi,  
Ëndërrën e tij e plotësoi  
Me prindët e tij  
Në galaktikë shkoi.

Jearti kur u zgjua,  
Me vrap shkoi  
Nënës së tij t'i tregojë.

## **Ëndrrat e mia**

Kam shumë ëndrra  
Në mendjen time,  
Medoj t'i realizoj,  
Në të ardhmen time.

Do bëhem mësuese  
Nxënësit t'i edukoj,  
Dhe nota të shkëlqyshme  
Në dëftesë t'iu shënoj.

Dua të bëhem këngëtare,  
Në koncerte të këndoj,  
E adhuresëve të mi,  
Autografe t'iu dhuroj.

Dua të bëhem mjeke  
Njerëzit ti shëroj,  
Jetën t'ua shpëtoj  
Dhe gjithëmonë ti gëzoj.

## **Fëmijët e botës**

Fëmijët e botës

Kanë një dëshirë,

Të jetojnë në liri,

Të jetojnë në harmoni.

Ndoshta fëmijët e botës

Nuk kanë liri,

E nuk kanë harmoni,

Por ato kanë lumturi,

Në brendësi.

Të gjithë fëmijët e botës

Meritojnë ardhmëri,

Të mirë e të ndritur

Të jetojnë të lumtur,

Në botën e bukur.

Të gjithë fëmijët e botës,

Janë si lule në saksi

Të gjithë kanë një dëshirë,

Të jetojnë në paqe e lumturi.

## **Festa e shkollës**

Festën e shkollës

Ne e festojmë,

Mësuesit tonë

Ne i urojmë.

Në festën e shkollës

Këndojmë dhe recitojmë,

Prindët tonë,

Në manifestim i ftojmë.

Festa më e bukur që egziston,

Është festa e shkollës tonë.

Shkollën tonë e adhurojmë,

Aty ne së bashku mësojmë,

Mësuesve, lulet më të bukura,

Me dëshirë, ua dhurojmë.

## **Fshati im**

Kur jam në fshatin tim,  
Unë, ndjejë gëzim.  
Në fshatin tim, unë mësoj,  
Prindët e mi me nota të mira,  
Gjithmonë i gëzojë.

Fshatin tim, unë e adhuroj,  
Çdo festë të vitit, aty e festoj,  
Deri tani kam jetuar me gëzim,  
Jetën time, dua ta kaloj në fshatin tim.

S'kam fjalë për ta përshkruar  
Fshatin tim, gjithmonë e kam ëndëruar,  
Fshati im është i veçantë,  
E dua fshatin, edhe pse s'është i artë.

## **Gjuha jonë**

Gjuhë e mirë,

Gjuhë e dliirë,

Gjuhë jonë,

Gjuha e bukur,

Gjuhë e artë,

Gjuhë e zjartë,

Gjuha e veçantë,

Më e vjetër,

Nga të gjitha gjuhët,

Gjuha shqipe,

Gjuha jonë.

## **Jetimi**

Po krijoj një poezi  
Ia kushtoi një fëmijut,  
Pa prindërit e tijë,  
Dhe pa shtëpi.

Nuk ka ku të merr ngrohtësi,  
Nuk ka ku të merr dashuri,  
Sepse nuk ka familjen e tijë.

Jetimi duhet ledhatuar,  
Jetimi duhet ndihmuar,  
Jetimi nuk duhet lënduar,  
Në shpirtin e tij ka shprastësi.

Kur të ritem para do grumbulloj,  
Dhe një jetim do ta mbroj,  
E para do ti dhuroj,  
Një jetë të mirë ti krijoj.

## **Kam nevojë**

Kam nevojë të mësoj,  
Mendjen ta pasuroj.

Kam nevojë të këndoj,  
Adhuresit ti gëzojë.

Kam nevojë të shkruaj,  
Poezi të krijojë.

Kam nevojë të punojë,  
Shumë në jetë të fitojë.



## **Katër stinët**

E para është pranvera,  
Stinë të luleve e quajnë.  
E pas sajë vjen vera,  
E pushimin në derë na sjell.  
Vjeshta vjen, e vera shkon  
Dhe mësimi në vjeshtë fillon.  
Më pas vjen dimri i ftohtë,  
Që mbulon vendin  
Me mbulesë të bardhë,  
Të bukur e të rallë.

## **Klasa ime**

Në klasën time

Unë mësoj mësimë,

Këndoj dhe lexojë

Notat e mira i meritojë.

Shkollën time

Sa herë e shikoj,

Klasën time e kujtoj,

Ku kam mësuar,

Ku jam argëtuar,

Me asgjë nuk dua,

Klasën time, ta ndroj,

Shumë e adhuroj.

Në klasën time

Dua të qëndëroj,

Me shoqet e mija

Gjithmonë të mësojë.

## **Libri**

Libra shumë

Duhet të lexojmë,

Që dituri të fitojmë,

Në të ardhmen

Të ditur të jemi,

Lumturi në familje të kemi.

Thesar me dituri

Librit ne i themi,

Se është i çmuar për ne,

Si dielli që bën dritë.

## **Luftë të mos ketë**

Mos të ketë luftë,  
Liria, le të egzistojë,  
Nerëzit të jenë të barabartë,  
Askush të mos i nënçmojë.

Ti lejojnë fëmijët  
Të rriten të lumtur,  
Me prindët e tyre  
Në botën e bukur.

Të jetojmë në paqe,  
Të ketë harmoni,  
Le të zhduket lufta,  
Të na sjell mirësi.

## **Mërgimi**

Në mërgim, nuk dua të qëndroj,  
Në vendin tim dua të shkoj,  
Dua të flas gjuhën e nënës sime  
Dua të jetoj në tokën time.  
Se atje kam shtëpinë,  
Aty kam kaluar fëmijërinë,  
Aty dua të kaloj dhe rininë.  
Në mërgim nuk dua të qëndroj,  
Për festa, nuk kam kë të uroj,  
Ne mërgim me familje, nuk dua të jetoj,  
Dua në shtëpi të shkoj .  
O mërgim i zi, ty s'të do njeri,  
Shumë njerës kanë mërguar,  
E vendlindjen e kanë haruar.  
Ju lus mos shkoni në mërgim,  
Mos e boshatisni vendin tim.

## **Mjeku**

Shumë njerëz i shpëton,  
Asnjëherë nuk dështon.

Mjeku punon me dëshirë,  
Njerëzve iu bënë mirë.

Shumë njerëz ka shpëtuar,  
Nga sëmundjet që i kanë kapluar.

## **Mësuesja ime**

Me ty mësuese

Ditë të mira kaluam,

Me rradhë çdo gjë mësuam,

Në klasë hyje

Gjithëmonë e buzëqeshur,

Ty mësuese, të desha me gjithë zemer.

Gjëra të bukura

Gjithëmonë na mësove,

Na mësove të shkruajmë,

Na, mësove të lexojmë,

Ty, mësuese do të kemi

Gjithmonë në zemër.

## **Natyra me ngjyra**

E bukur është natyra,  
E mbuluar me lule me ngjyra.

Natyrë ti ke gjelbërim,  
Ti na sjell vetëm gëzim.

Ti natyrë na sjell lumturi,  
Ti natyrë je për bukuri.

Natyrë me bardhësi,  
Është dhuratë nga dimri.

Ftohësia e natyrës,  
Është dhuratë prej vjeshtës.

Nxehtësi nga vera,  
Vjen pranvera me manafera.

Natyrë me luleborë,  
Natyres gjithçka i shkon për dore.



## **Nëna**

Nëna që më lindi,  
Nëna që më riti,  
Nëna që më edukon,  
Nëna që gjithçka për mua bën.

Të dua shumë, nëna ime  
Ti je diamant me rreze drite,  
Ti je dielli që shëndrit,  
Çdo natë e çdo ditë.

Tek ti fillon jeta,  
Aty fillon e rreh zemra  
Me ty ecën fëmijëria,  
Fjala nënë është gjithësia.

Ti je ajo që më fal dashuri,  
Je dhuratë me plot mirësi,  
Je ëngjëll, që gjithmon  
Në rrugë të mirë, më udhëzon.

Oh moj nënë, nëna ime  
Të mërzhitur s'të shoh dot,  
Shumë je munduar  
Neve për ta na mësuar.

## **Gjyshit tim**

7 shkurti ditë e shtunë

E mora lajmin e trishtuar

Se ti ke ikur nga kjo botë

Këtë dhimbje se duroj dotë

Me veprat tua ende jeton

Kush ka dhimbje ende të kërkon

Për çdo fëmijë, plak e të rri

E vetmja shpresë në sëmundje ishe ti

Në çdo dhimbje e shqetësim

Ishe shpresë e lehtësim

E di Gjysh se më shiqoni

Promovimin e Librit ma uroni

Unë jam Mbesa juaj e parë

A andaj dua të ju bëj krenar

Juve veprën ua dedikoj

Kurrë për jetë nuk ju haroj

## **Një tufë me lule**

Një tufë me lule  
Kam në dorën time,  
Dua t'ia jap  
Më të shtrenjtës sime.

T'ia uroj tetë marsin  
Nënës sime,  
Të ia festoj këtë festë,  
Me shumë gëzime.

Nënë moj e shtrejta ime,  
Ty gjithmonë të kam  
Në mendime,- të adhuroj,  
Asnjëherë s'të haroj,  
Gjithmonë të ëndëroj,  
Jam e lumtur, që me ty jetoj.

## **Njeriu**

Njeriu jeton

Edhe pse dështon,

Ndoshta ai ndonjëherë nuk dëgjon,

Po ai ndjenë, e nuk tregon.

Njeriu është i fortë,

Çfar nuk përballon,

Po sërisht nuk vajton.

Ka njerës me dy fytyra,

Si ylberi me shumë ngjyra,

Sejçilët që i takojnë,

Fytyrën e ndrojnë.

## Poeti

Shkronja, fjalë  
Shkruan poeti,  
Dalë nga dalë.

Prozë e poezi,  
Shkruan edhe vepra  
Me dëshirën e tijë.

Përalla e tregime  
Shkruan poeti,  
I zhytur në mendime.

Shkruan bashkë  
Me vetëveten,  
Ditën, natën  
E tërë jetën.

Edhe kur shkon,  
Lë pas dhurata,  
Vepra të shkurtëra  
Vepra të gjata.

## **Prindërit e mi**

Sikur deti që ka ujë,  
Dhe qelli ka kaltërsinë  
Aq, është e madhe dashuria,  
Për prindërit e mi.

Nëna jetën ma dhuroi  
Dhe me mund, më edukoj,  
Babi është ai që dëshirat  
Gjithmonë mi plotëson.

Nëna dhe Babi, janë  
Njerëz të shtrenjtë,  
Që unë i adhuroj  
E në jetë nuk i haroj.

## **Qeshuni fëmijë**

Qeshuni o fëmijë,  
Sikur bota të jetë një,  
Qeshuni e mos nguroni,  
Të palumtur mos qëndroni.

Kur buzëqeshni ju,  
Buzëqeshim edhe ne,  
Buzëqesh natyra,  
Lulet për mbi dhe.

Botës fëmijërore  
Duhet përkushtuar,  
Duhet bërë diçka  
Duhet interesuar.

## **Shkolla**

Për në shkollë  
Të gjithë vrapojmë,  
Se e dimë që dituri  
Në të fitojmë.

Disa nxënës  
Nuk mësojnë,  
Shumë në jetë, ata gobojnë,  
Sepse diturinë nuk e fitojnë.

Në shkollë marrim dituri,  
Shkolla, dhe na arsimon,  
Shkolla, librat dhe mësuesit  
Çdo lëvdatë, e meritojnë.

Mësuesit punojnë,  
Me shumë dëshirë,  
E dinë që mësimi  
Nxënësve, ju bën mirë.

Kudo që isha,  
Kudo që shkova,  
Si shkolla ime  
Nuk takova.



## **Shoqja ime**

Kam një shoqe  
Shumë të bukur,  
Ajo gjithmonë  
Është e lumtur.  
Si motër të kam,  
Si motër të konsideroj,  
Kur jamë e mërzitur,  
Gjithmonë më gëzon,  
Dua të të them,  
Falemenderit që egziston.

## **Shtëpia ime**

Në mes të fshatit  
Ndodhet shtëpia ime,  
Aty unë jetoj  
Me familjen time.

Në shtëpinë time  
Bëjmë manifestime,  
Lozim e këndojmë,  
Pindët i gëzojmë.

Shtëpia ime  
Është e mbushur me gëzime,  
Është e mbushur me ngrohtësi,  
Neve na sjell lumturi.

## **Të mësuarit**

Nëse ti mëson,  
Shumë fiton,  
Prindët i gëzon,  
E lumtur jeton.

Nëse mëson,  
Dituri fiton,  
Mendjen e pasuron,  
Në jetë përparon.

Nëse ti nuk mëson,  
Shumë gabon,  
Dituri nuk fiton,  
E lumtur nuk jeton.

## **Tragjedi**

O moj shqipëri,  
E mjera shqipëri,  
Si të kaploi  
E gjithë kjo tragjedi,  
Ku humbën jetën  
Shumë gra e fëmijë,  
Shumë pleq e të rinj.

Rra ky tërmet, e dridhi tokën,  
E frikësoi gjithë botën,  
Shumë pallate u rrënuan,  
Shumë familje u shkatruan.

Në këmbë u ngrit  
E gjithë shqiptaria,  
T'iu ndihmojë  
Vëllezërve nga Shqipëria.

Me shpirtë e zemër  
Dhimbjen me ju e ndajmë,  
Një komb jemi,  
Veç kufijtë na ndajnë.

## **Udhëtimi**

Një ditë udhëtuam  
Me familjen time,  
Në pushim shkova.  
Gajtë udhëtimin,  
Shumë mirë kalova,  
Po në fund u rëzova.  
U ngrita me shpejtësi,  
Shikova se mos më pa  
Dikush fshehurazi.  
Familjarët e mi, po qeshnin  
Me lotë në sy,  
Unë isha lënduar  
Po qeshja duke qarë.

## **Varfëria**

Një ditë po qëndroja,  
Duke menduar,  
Ç'bëjnë të varfërit,  
Pa shtëpi.  
A kanë hall, a kanë mërzi,  
Ndoshta ato nuk kanë pasuri,  
Po ato kanë dashuri.  
Ato nuk kanë armiqësi,  
Ndoshta dhe ata kanë një dëshirë,  
Të jetojnë në shtëpi, të lirë.  
Ndoshta edhe ata ëndërojnë,  
Në shtëpitë e tyre të jetojnë.  
Unë të varfërit i ndihmojë,  
Para grumbulloj dhe ua dhuroj,  
E ata i gëzoj.  
Një ditë një të varfëri,  
Para i dhurova,  
Në sytë e tij,  
Gëzimin shikova.

## **Vendlindjes**

Vendlindjen time

Unë shumë e dua,

Është vendi ku u linda,

Është vendi ku u rita.

Kur jam në vendin tim,

I çlodhi sytë në gjelbërim,

E shijoj erën e trëndafilut,

E dëgjoj këngën e bilbilit.

## **Viti i Ri**

Viti i Ri, Viti i Ri

Mirë se erdhe ti,

Ne fëmijët u gëzuam,

Që një vit të lumtur jetuam.

Stolisëm bredhin

Me plot stoli

Mirë se erdhe

Viti i Ri

Me fishekzjare

E valle plot,

Të gëzuar

Përcjellim një mot.

Babadimrin me shumë dhurata,

E presim, si në përalla,

Të na plotësoj dëshirat,

Për mrekulli, në Vitin e Ri.



## *Përmbajtja*

Gjyshit tim .....	5
Atdheu.....	6
Babi.....	7
Biblioteka.....	8
Dëshirat.....	9
Dimri.....	10
Ditëlindja .....	11
Dua një botë.....	12
Dua të kursej.....	13
Edhe unë dua.....	14
Ëndërrat e Jeartit.....	15
Ëndrrat e mia.....	16
Fëmijët e botës.....	17
Festa e shkollës.....	18
Fshati im .....	19
Gjuha jonë.....	20
Jetimi.....	21
Kam nevojë.....	22
Katër stinët.....	23
Klasa ime .....	24
Libri .....	25
Luftë të mos ketë .....	26

Mërgimi .....	27
Mjeku .....	28
Mësuesja ime .....	29
Natyra me ngjyra .....	30
Nëna .....	31
Gjyshit tim .....	32
Një tufë me lule .....	33
Njeriu .....	34
Poeti .....	35
Prindërit e mi .....	36
Qeshuni fëmijë.....	37
Shkolla .....	38
Shoqja ime .....	39
Shtëpia ime .....	40
Të mësuarit .....	41
Tragjedi.....	42
Udhëtimi .....	43
Varfëria .....	44
Vendlindjes .....	45
Viti i Ri .....	46

# *Blendiana Nuredini*



**Është nxënëse e klasës së gjashtë**

**në Shkollën fillore periferike komunale "Fan Noli" të f. Pallaticë.**

**Lindi në Tetovë në vitin 2008, bashkjeton me familjen në f. Pallaticë.**

**Është vepra e parë e saj.**

**Me krijime letrare poetike fillon në klasë të gjashtë,**

**gjegjësisht me postimin e poezisë së parë "Vendlindjes" në shtator, te faqja e shkollës.**

**Më pas u radhitën edhe poezitë tjera të cilat ishin parakusht për dalje në dritë të veprës.**

**Blendiana është nxënëse e shkëlqyeshme, merr pjesë në shumë aktivitete shkollore.**

**Është ardhëria e krijimeve letrare në f. Pallaticë dhe më gjërë.**